2. “Maliq Haka” p.f me Nipt: L 32829201 A

Shumatorja e çmimeve për njësi e paraqitur në procedurën e prokurimit është 75,945 (shtatëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e dyzet e pesë) lekë (pa tvsh).

2. “Vassa” sh.p.k me Nipt: J 62903470 T

Shumatorja e çmimeve për njësi e paraqitur në procedurën e prokurimit është 76,183 (shtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e tetëdhjetë e tre) lekë (pa tvsh).

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. “Maliq Haka” p.f me Nipt: L 32829201 A

Përkatesisht për arsyet e mëposhtme:

1. Ofertuesi “Maliq Haka” p.f, skualifikohet për arsye se: Ky operator kishte mangësi në dokumentacionin e paraqitur e konkretisht:

1. Në pikën 2.3.2 të Kapacitetit Teknik të DST kërkohet : Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori zyrtar për mallrat objekt prokurimi kjo e vërtetuar nëpërmjet dokumentave origjinal ose të noterizuar si përfaqësues i kompanisë prodhuese për të gjithë mallin/mallrat objekt prokurimi. Në rast paraqitje autorizimi distributori, operatori ekonomik duhet të paraqesë në letër angazhim ose akt marrëveshje midis prodhuesit dhe distributorit e vlefshme midis tyre.

Operatori Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri, ka paraqitur një autorizim nga A.Davleris S.A. i cili është në gjuhën angleze dhe jo shqipe, "Bazuar ne seksionin 4 te DST, specifikisht pika 4.6 , gjuha e perzgjedhur per hartimin e dokumentave te tenderit eshte shqipja, prandaj cdo dokumentacion i paraqitur nga OE duhet te jete ne perputhje me gjuhen e zgjedhur, ose ne gjuhe te huaj , i perkthyer dhe i noterizuar sipas legjislacionit ne fuqi."

Operatori Ekonomik nuk kualifikohet në lidhje me këtë kriter.

2. Në pikën 2.3.4 te Kapacitetit Teknik të DST kërkohet: Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve e prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë mallrat që do të ofrohen.

Operatori Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri , nuk ka paraqitur asnjë katalog të mallrave objekt prokurimi.

Operatori Ekonomik nuk kualifikohet ne lidhje me këtë kriter.

3. Në pikën 2.3.8 të Kapacitetit Teknik të DST kërkohet: Për materialet (automat, çelësa, priza, tela, kabëll) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë raportin e testimit i cili duhet të jetë kryer nga laboratorë testues të çertifikuar me ISO 17025:2005 ose ekuivalente nga institucione kombëtare ose ndërkombëtare të akreditimit, me qëllim përmbushjen e specifikimeve teknike.

Operatori Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri , ka paraqitur një raport testimi vetëm për celesat dhe prizat, por që nuk është kryer nga laboratorë testues të certifikuar me ISO 17025:2005 ose ekuivalente nga institucione kombëtare ose ndërkombëtare të akreditimit.

Operatori Ekonomik nuk kualifikohet ne lidhje me këtë kriter.

4. Operatori Ekonomik nuk ka plotësuar pikën 6 të Shtojcës 2/1: Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur.

5. Operatori Ekonomik në përmbushje të pikes 2.3.9 te Kapacitetit Teknik të DST ka paraqitur mostrat e kërkuara nga AK, por për elementin : Lamba 250 W të Bardha 3800 Kelvin, OE ka dorëzuar një llambe 250 W të Bardha 4000 Kelvin, si dhe për elementin Pllaketa LED 100 W, ka dorëzuar një pllaketë të cilës nuk i përputhet kodi sipas specifikimeve teknike të kërkuara. Kjo e dokumentuar me proces-verbal të mbajtur ditën e dorëzimit të mostrave.

Operatori Ekonomik nuk kualifikohet ne lidhje me këtë kriter.

Në nenin 46, pika 1/b, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se : "[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës[...]"

" Ndërsa në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar parashikohet se "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji."

Sa mësipër komisioni i vlerësimit të ofertave vendosi ta refuzojë ofertën

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. “Vassa” sh.p.k me Nipt: J 62903470 T

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar është 76,183 (shtatëdhjetë e gjashtëmijë e njëqind e tetëdhjetë e tre) lekë (pa tvsh).

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë Bashkisë Elbasan (Drejtoria e Prokurimeve), brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 30.07.2020

Ankesa: nuk ka pasur

SHËRBIMI PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAT

Për: Bashkimin e Operatorëve ekonomikë “B-93” SHPK dhe “Aurora Konstruksion” SHPK me adresë të kryesuesit të BOE, të shoqërisë: “B-93” SHPK: *Lagjja “8 Shkurti”, Rruga “Andon Doro”, zona kadastrale 8533, nr. pasurie 1/270, Fier.*

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur”

Numri i referencës së procedurës: REF-60559-06-08-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Rikonstruksion i godinës së Shërbimeve të Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” me fond limit: 41,946,377 (dyzetë e një milion e nëntëqind e dyzetë e gjashtë mijë e treqind e shtaëdhjetë e shtatë) lekë (Vlera pa TVSH) dhe kohëzgjatja e kontratës 8 (tetë) muaj nga nënshkrimi i saj.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- 1) BOE “B-93” SHPK dhe “Aurora Konstruksion” SHPK; J62903508R dhe K02017003I
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
Vlera: 32,551,491 (tridhjetë e dymilionepesëqindpesëdhjetëenjëmijëekatërqindenëntëdhjetëenjë) lekë (pa TVSH) (me numra dhe fjalë)
- 2) “BE – IS” SHPK K71412003A
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
Vlera: 34,648,896 lekë (tridhjetë e katërmilion e gjashtëqind e dyzetë e tetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë (pa TVSH) (me numra dhe fjalë)

3) “ALBA KONSTRUKSION” SHPK J61812013R
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it
 Vlera: 35,250,807 (tridhjetë e pesëmilionedyqindpesëdhjetëmijëetëqindeshtatë) lekë (pa TVSH) (me numra dhe fjalë)

4) “C O L O M B O” SHPK J82916489E
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it
 Vlera: 31,432,076 (tridhjetë e njëmilione katër qind e tridhjetë e dy mijë e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë (pa TVSH) (me numra dhe fjalë)

5) “HASTOÇI” SHPK J62028009B
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it
 Vlera: 36,553,084 (tridhjetë e gjashtë milion e pesë qind e pesëdhjetë e tremijë e tetëdhjetë e katër) lekë (pa TVSH) (me numra dhe fjalë)

6) “MIDEA ALBANIA” SHPK K01510004R
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it
 Vlera: 0 (zero)

7) “ELDA VL” SHPK K67106202W
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it
 Vlera: 0 (zero)

Janë s’kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1) “C O L O M B O” SHPK J82916489E
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

2) “HASTOÇI” SHPK J62028009B
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

3) “MIDEA ALBANIA” SHPK K01510004R
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

4) “ELDA VL” SHPK K67106202W
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyt e mëposhtme:

Arsyet e s’kualifikimit për “C O L O M B O” SHPK;

- Arsyeja e skualifikimit: Operatori ekonomik, ka paraqitur njëcmim oferte pa gabime matematikore në preventivin ku detajohet sasi * çmim, por në shumën totale pa tvsh ka përfshirë edhe vlerën e makinerive e pajisjeve (seksioni G) dhe pasi ka perlllogarit tvsh-në mbi këtë totale serish ka shtuar vlerën e pajisjeve (pa tvsh) duke rezultuar kështu një oferte e pasakte.
- Në ketellogjike është deklaruar një oferte me çmim prej 31,432,076 leke (pa tvsh), e cila sipas perlllogaritjeve të sakta rezultoi të jetë 25,586,452 leke (pa tvsh).

- Diferenca e gabimit matematikor e kalon +/- 2% te ofertes (pasi eshte ne shumen prej 5,845,624 leke) duke e bere nje oferte te pavlefshme sicpercaktohet ne piken 4 te nenit 66 te VKM-se nr.914, date 29.12.2014 “Permiratimine rregullave te prokurimit publik” (i ndryshuar). Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumet absolute te te gjitha korrigjimeve jane me shume se +/- 2% e vleres se ofertes ekonomike te ofruar.

Arsyet e s’kualifikimit për“HASTOÇI” SHPK;

- Arsyeja e skualifikimit: operatori ekonomik, ka paraqitur njecmim oferte te sakte dhe pa gabime ne preventivin ku detajohet sasi * çmim. Por ka njemosperputhje mes vlerave te sakta te konkluduara ne perfundim te preventivit (38,473,494 leke pa tvsh) me ate te deklaruar ne cmimin oferte ne fillim te faqes (36,553,084 leke pa tvsh).
- Diferenca e gabimit matematikor e kalon +/- 2% te ofertes (pasi eshte ne shumen prej 1,920,410 leke) duke e bere nje oferte te pavlefshme sicpercaktohet ne piken 4 te nenit 66 te VKM-se nr.914, date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” (i ndryshuar). Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumet absolute te te gjitha korrigjimeve jane me shume se +/- 2% e vleres se ofertes ekonomike te ofruar.

Arsyet e s’kualifikimit për“MIDEA ALBANIA” SHPK;

- Arsyeja e skualifikimit: Operatori ekonomik nuk paraqitur dokumentacionin e kërkuar sipas DST-së.

Arsyet e s’kualifikimit për “ELDA VL” SHPK;

- Arsyeja e skualifikimit: Operatori ekonomik nuk paraqitur dokumentacionin e kërkuar sipas DST-së.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatorëve ekonomikë “B-93” SHPK dhe “Aurora Konstruksion” SHPK me adresëtë kryesuesit të BOE të shoqërisë: “B-93” SHPK: Lagjja “8 Shkurti”, Rruga “AndonDoro”, zona kadastrale 8533, nr. pasurie 1/270, Fier,se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 32,551,491 (tridhjetë e dy milion e pesëqind e pesëdhjetë e një mijë e katërqind e nëntëdhjetë e një) lekë (pa TVSH) është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, Adresa: Sheshi Skënderbej, nr.3, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentet e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 28.07.2020

Ankesa: JO

AUTORITETI PORTUAL DURRËS

Për: "Gajd Company" Shpk, Nipt K79631501Q

Adresa: Rruga Fushe-Tepelene, Zone Kadastrale Nr.3574, Nr.Pasurie 8/22, Gjirokaster Tepelene

* * *

Procedura e prokurimit: "Kerkesë për propozim" (Prokurim me mjete elektronike).

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-64685-07-08-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Blerje gomash" me kohëzgjatje 30 (tridhjetë) ditë

Buletini i Njoftimeve Publike: 13.07.2020, Nr. 42.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Varvara Shpk me Nipt K52506801_me vlere te ofertes ekonomike 2.569.300.leke (dy milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e treqind), pa tvsh
2. Klosi-R Company Shpk me Nipt L72120030I nuk ka ngarkuar ofertë ekonomike në SPE
3. Gajd Company Shpk me Nipt K79631501Q me vlere te ofertes ekonomike 2.388.000.leke (dy milion e treqind e tetëdhjetë e tetë mijë), pa tvsh

Janë s'kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- Varvara Shpk me Nipt K52506801 me vlere te ofertes ekonomike 2.569.300 (dy milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e treqind)lekë, pa tvsh

Në dokumentacionin e paraqitur nga ky operator, KVO ka evidentuar keto mangësi.

1. Pika dh- Kriteret e Vecanta te Kualifikimit "Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri", OE ka paraqitur dokument te muajit qershor ku nuk eshte perfshire/paguar muaji Maj 2020.

2. Ne DST kerkuar nga AK pika 2.3.5 e Krieteve te Vecanta te Kualifikimit nuk eshte paraqitur dokumenti titulluar "Oferte Teknike " me te gjitha te dhenat e nevojshme te kerkuara si me poshte cituar:

Dokumentin e titulluar Ofertë Teknike i paraqitur nga Autoriteti Kontraktor ne formen e nje dokumenti kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi per te gjithë artikujt e Listes.

Oferta teknike duhet te permbaje te dhena si:

- a) Emri, i kompanise prodhuese ose distributor i autorizuar nga prodhuesi me produktet e te cileve Operatori Ekonomik do te paraqitet ne dokumentat e ofertimit.
- b) Adresa dhe ëeb-sit te sakta te kompanise prodhuese ose distributorit te autorizuar.
- c) Emertimi i Katalogut te prodhuesit.

- d) Referenca e zerit te ofertes teknike ne nr. e faqes se katalogut, te shenuar me nje shenje te dukshme per tu verifikuar ne te cilen Autoriteti Kontraktor mund te gjeje specifikimet e plota teknike te ofruara nga Operatori.
- e) Hartimi dhe plotesimi i kerkesave te Ofertes Teknike pikave me siper (a,b,c,d) me siper, kerkohet qe; Te kryhet nga vete ofertuesi per te vleresuar ne kete menyre nese; Gomat qe ofrohen jane ne perputhje me ato qe kerkohen prej Autoritetit Kontraktor ne DT. Mos plotesimi i ketyre pikave do te sjelle pavleshmeri te ofertes.

3. Ne piken 2.2.2 AK ka kerkuar:

"Kompanite prodhuese te produkteve te ofruara goma pneumatike kerkohet te jene te certifikuara sipas normave ISO 9001 -2015 te standartit nderkombetar te menaxhimit te cilesise dhe ose te njevlefshme , te cilat do te garantonin cilesine e Produktit. Fusha e certifikimit duhet te perkoje me kategorine dhe specifikat e shenuara te produkteve qe prokurohen si me siper. Çertifikatat duhet te jene te vlefshme,. Deshmia per zoterimin e saj duhet te jepet nepermjet origjinalit ose kopje te njehsuar të Origjinalit. Ne rast se eshte ne gjuhe te huaj kerkohet e perkthyer dhe e noterizuar."

Çertifikata ISO 9001-2015 e Kompanise Prodhuese " Balkrishna Industries Limited (BKT) " e paraqitur nga OE nuk eshte e vlefshme pasi ka skaduar ne 17 Tetor 2019 dhe eshte ne gjuhe te huaj e pa perkthyer dhe pa noterizuar.

4. OE ka paraqitur dokumentat e titulluara " DISTRIBUTOR_BKT_TIRE (_VARVARA_SHPK)" dhe " DISTRIBUTOR_Hankook_and_Laufenn_Brand (_VARVARA_SH.P.K)_in_Albania." te cilet jane te pa perkthyer dhe te pa noterizuar ne mosplotesim me kerkesat e DST si me poshte cituar:

"Pika 2.3.9 " Operatori ekonomik duhet te paraqese Autorizim nga prodhuesi. Ne rast se furnizues per operatorin ekonomik nuk do te jete kompani prodhuese por distributor i saj atehere ofertuesi ekonomik duhet te demostroje se ky Distributor eshte i Autorizuar nga Kompani prodhuese me ane te Dokument/a origjinale ose te noterizuara me te gjitha te dhenat te verifikueshme, ose Shenuar ne ëeb-sitin e kompanise prodhuese si shites (dealer)."

5. Ne kataloget e paraqitur nga OE nuk ka asnje shenim te dukshem kerkuar nga AK ne DST sipas pikes 2.3.5 ; dh-" Referenca e zerit te ofertes teknike ne nr. e faqes se katalogut, te shenuar me nje shenje te dukshme per tu verifikuar ne te cilen Autoriteti Kontraktor mund te gjeje specifikimet e plota teknike te ofruara nga Operatori."

6. Per artikullin e kerkuar nepermjet skedes teknike Nr.2, per artikullin nr.8 te listes se gomave, OE ka paraqitur dy kataloge teknike me emertimet " em-937-ind3-ech-14_00-24-0621-msi" dhe " bkt-port-brochure-en-us_(1)" ne te cilat specifikimet teknik i tipit te gomes eshte dhene ne dy versione TT dhe TL.

Kjo ka krijuar pamundesie per vleresim pasi skeda teknike kerkohet ne TT dhe jo TL.

Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, rezulton se, oferta e operatorit ekonomik "VARVARA" SHPK , Nipt K52506801, nuk i përmbush të gjitha kriteret e kërkuara në Dokumentat e Tenderit dhe, për rrjedhojë, KVO vendosi të skualifikoje këtë ofertë.

- Klosi-R Company Shpk me Nipt L72120030I

Në dokumentacionin e paraqitur nga ky operator, KVO ka evidentuar keto mangësi.

Mungon dorezimi i dokumentacionit te plote sipas DST. Ka dorezuar vetem Vertetim punonjesish dhe vertetetim xhiro 2018.

Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, rezulton se, oferta e operatorit ekonomik “Klosi-R Company” SHPK , NIPT L72120030I nuk i përmbush të gjitha kriteret e kërkuara në Dokumentat e Tenderit dhe, për rrjedhojë, KVO vendosi të skualifikojë këtë ofertë.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik “Gajd Company” Shpk me Nipt K79631501Q, me adresë, Rruga Fushe-Tepelene, Zone Kadastrale Nr.3574, Nr.Pasurie 8/22, Gjirokaster Tepelene se oferta e paraqitur, në vlerë të ofertes ekonomike 2.388.000 (dy milion e treqind e tetëdhjetë e tetë mijë) lekë, pa tvsh, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Portual Durrës, Lagjja nr. 1, Rruga Tregtare, Durrës, Tel 052-293420, sigurimin e kontratës siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar), siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datën 30/07/2020 .

- Ankesa: - “SI & CO” Company Shpk,” Shpk
Ka marrë përgjigje me datë 21/07/2020 me shkresën nr.2236/1 Prot.
- “Eral Construction Company” Shpk
Ka marrë përgjigje me datë 21/07/2020 me shkresën nr.2237/1 Prot.

BASHKIA MALIQ

Për OPERATORIN EKONOMIK “ Alb korça 2002“ shpk
NIPTI: K34004003T

Adresa: Korçë , Pojan , Zëmlak , Lagjja Qëndër, pranë nënstacionit Zëmlak, KORÇË
Procedura e prokurimit: : Kërkesë për propozim/ Pune/Sistem Elektronik

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-64029-07-03-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Rrjeti i brendshëm i ujësjellësit Shqitas”
Afati i kontratës: 2 muaj

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.42 datë 13.07.2020
Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qene pjesemarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “ Alb Korça 2002 ” shpk
 - Adresa : Korçë , Pojan , Zëmlak , Lagjja Qëndër, pranë nënstacionit Zëmlak, KORÇË
 - NIPT-I : K34004003T
 - Vlera e ofertës së ofruar është : 2 250 160 lekë pa tvsh
2. Operatori ekonomik “ 2N ” shpk
 - Adresa : Lagja Paskuqan fushe, rruga Demokracia , pallatiNr. 2 kati i pare, Paskuqan Tiranë
 - NIPT-I : L31615017L
 - Vlera e ofertës së ofruar është : 2 955 900 lekë pa tvsh
3. Operatori Ekonomik “ Avduli ” shpk
 - Adresa :Lagjja 10 Korriku , rruga Perlat Rexhepi , objekt 3 katësh Nr.4 , kati I , VLORË
 - NIPT-I : J66703306O
 - Vlera e ofertës së ofruar është : 2 559 950 lekë pa tvsh
4. Operatori Ekonomik “ FLED ” shpk
 - Adresa : , Berat, lagjja “Havaleas”,ura e Kozarës, Kuçovë godinë 1 kateshe nr.307 KUÇOVË
 - NIPT-I : K17621104C
 - Vlera e ofertës së ofruar është : 3 182 700 lekë pa tvsh
5. Operatori Ekonomik “ INA ” shpk
 - Adresa:Rruga Besim Imami , Myslym Shuri , mbrapa karburantit , Tiranë
 - NIPT-I : J61814009W
 - Vlera e ofertës së ofruar është : 2 279 530 lekë pa tvsh
6. Operatori Ekonomik “ K.M.K” shpk
 - Adresa : Bulevardi Rrapo Hekali , shkala 1, kati 1 , Ballsh -Mallakastër , Ballsh , FIER
 - NIPT-I : L78223801E
 - Vlera e ofertës së ofruar është : 3 230 100 lekë pa tvsh
7. Operatori Ekonomik “ Liqeni VII ”shpk
 - Adresa : RRuga Dituria , Lagjja 14 , Kodi Postar 2007 Shkozet , Durrës
 - NIPT-i : K01730502W
 - Vlera e ofertës së ofruar është : 3 067 450 lekë pa tvsh
8. Operatori Ekonomik “NIKA ” shpk
 - Adresa : SHKODËR ,lagjja Vasil Shanto,Bulevardi Skënderbeu,godinë 8-katëshe,kati I-rë
 - NIPT-i : J76705047U
 - Vlera e ofertës së ofruar është :2 576 820 lekë pa tvsh
9. Operatori Ekonomik “ SARK ” shpk
 - Adresa : Lagjja 8 Shkurti, rruga Skenderbej Rajoni 3, përballë supermarket Lalaj Fier
 - NIPT-i: K52531415
 - Vlera e ofertës së ofruar është :2 927 689 lekë pa tvsh
10. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “Xhengo “ shpk & “ Meni ” shpk
 - Operatori ekonomik “ Meni “ shpk
 - Adresa: Tiranë, Njësia Bashkiake Nr.8, rruga Shinasi Dishnica , pallati Unicom nr.1 hyrja A ,
 - NIPT-i: J61909018W
 - Vlera e ofertës së ofruar është :3 412 141 lekë pa tvsh
 - Operatori ekonomik “ Xhengo “ shpk
 - Adresa: RRuga Don Gjon Buzuku , lagjja .5 Korçë

-NIPT-i: J64103171M

-Vlera e ofertës së ofruar është : 2 631 130 lekë pa tvsh

Operatorët ekonomikë të s'kualifikuar janë:

1. Operatori Ekonomik “2N” shpk nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim sepse
 - Nuk ka pune të ngjashme
 - Manovratorët e paraqitur nuk janë të pajisur me Dëshmi të Aftësisë Profesionale (DAP) por me lejë manovrimi (afati i vlefshmërisë të tyre është 5 vjet)
 - Mungon mjete kamion (mjetit kamion me targa AA193OK i ka përfunduar afati i vlefshmërisë së kontrollit teknik dhe policës e Siguracionit datë 21.07.2020
2. Operatori Ekonomik “FLED” shpk nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim sepse
 - Nuk ka punë të ngjashme
3. Operatori Ekonomik “Liqeni VII” shpk nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim sepse
 - Mungon mjete kamion (mjete me targa AA 279 GG në kontratën e qirasë është përcaktuar kamion me peshë 4.2-9.2 ton dhe i ka përfunduar afati i vlefshmërisë së kontrollit teknik dhe policës e Siguracionit datë 06.05.2020)
4. Operatori Ekonomik “Nika” shpk nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim sepse
 - Nuk ka punë të ngjashme
 - Mungon mjete eskavator me goma
- 5 . Operatori Ekonomik “ SARK ” shpk nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim sepse :
 - Ing. ndertimit Ledion Xharo nuk është i përfshirë në listë pagesa për periudhën e kërkuar
 - Mungon mjete kamion , mjetet e paraqitura nuk janë sipas përcaktimeve të Autoritet Kontraktor (mjete me targa AA673TY është tërheqës dhe jo kamion dhe mjete me targa AA460Dn është kamion me peshë 18-42 ton)
 - Mungon mjete autobot (mjetit me targa AA461NI i ka përfunduar afati i vlefshmërisë së kontrollit teknik dhe policës e Siguracionit datë 22.01.2020)
- 6 . Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “ Xhengo “ shpk & “ MENI “ shpk nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim sepse :
 - Për OE “ Meni “ shpk mungon vërtetimi i xhiros vejtore
 - Mungon mjete eskavator

Operatorët ekonomikë të kualifikuar janë:

1. Operatori ekonomik “ Alb Korça 2002 ” shpk
 - Adresa : Korçë , Pojan , Zëmlak , Lagjja Qëndër, pranë nënstacionit Zëmlak, KORÇË

- NIPT-I : K34004003T
- Vlera e ofertës së ofruar është : 2 250 160 lekë pa tvsh

2. Operatori Ekonomik “ INA ” shpk

-Adresa:Rruga Besim Imami , Myslym Shuri , mbrapa karburantit , Tiranë

-NIPT-I : J61814009W

-Vlera e ofertës së ofruar është : 2 279 530 lekë pa tvsh

3 .Operatori Ekonomik “ Avduli ” shpk

-Adresa :Lagjja 10 Korriku , rruga Perlat Rexhepi , objekt 3 katësh Nr.4 , kati I , VLORË

-NIPT-I : J66703306O

-Vlera e ofertës së ofruar është : 2 559 950 lekë pa tvsh

4. Operatori Ekonomik “ K.M.K” shpk

-Adresa : Bulevardi Rrapo Hekali , shkala 1, kati 1 , Ballsh -Mallakastër , Ballsh , FIER

-NIPT-I : L78223801E

-Vlera e ofertës së ofruar është : 3 230 100 lekë pa tvsh

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik “ Alb Korça 2002 ” shpk me NIPT: K34004003T dhe adresë: Adresa Korçë , Pojan , Zëmlak , Lagjja Qëndër, pranë nënstacionit Zëmlak, KORÇË :se oferta e paraqitur,me një vlerë të përgjithshme 2 250 160 (dy milion e dyqind e pesëdhjet mijë e njëqind e gjashtëdhjet) lekë pa tvsh. pikët totale të marra [] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [BASHKIA MALIQ, BULEVARDI RINIA, MALIQ, KORÇË] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi. Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës , kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 2 279 530 (dy milion e dyqind e shtatëdhjet e nëntë mijë e pesëqind e tridhjet) lekë pa tvsh , siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë : 30.07.2020

Ankesa: NUK KA

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë

INSPEKTORATI SHTETËROR I MBIKËQYRJES SË TREGUT

Për: “NOVAMAT” SHPK, me adresë:Rruga “IsmailQemali”, pallati “SamosTower”, kati 8, nr 41,Tiranë.

Procedura e prokurimit:Kërkesë për Propozim

Numri i referencës së procedurës:REF-64283-07-06-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje pajisje dhe instrumenta për testim dhe inspektim në terren”, me fond limit 5,000,000(pesë milion) Lekë pa TVSH Lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: Afati i lëvrimit do të jetë Brenda 20 ditëve nga lidhja e kontratës.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: X çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, operatorët ekonomikë si më poshtë:

- 1- Operatori ekonomik “LuarBros” SHPK me NIPT L72322004M me ofertë ekonomike 2.718.090 (dy milion e shtatëqind e tetëmbëdhjetë mijë e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH.
- 2- Operatori ekonomik “Novamat” SHPK me NIPT K81615002O, me ofertë ekonomike 4.919.000 (katër milion e nëntëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të si më poshtë:

- | | |
|---------------------------------|------------------------|
| 1) “LuarBros” SHPK | L72322004M |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Nuk plotëson pikën 2 të Kapacitetit Teknik pasi dokumenti i paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, si referencë, nuk është i vlefshëm pasi kjo e fundit nuk është e akredituar sipas standartit ISO 17025, si rrjedhojë kalibrimet e instrumentave matës ligjërisht të kontrolluar, të kalibruar nga ky institucion nuk njihen nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri si dhe nga laboratorët e akredituar sipas marrëveshjes së MLA-së ku Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit bën pjesë.
- Nuk plotëson pikën 3 të Kapacitetit Teknik pasi dokumenti i paraqitur si Autorizim nga distributori “MICOM” nuk është i përkthyer në gjuhën shqipe. Gjithashtu nuk është paraqitur asnjë dokument që të vërtetojë lidhjen midis distributorit dhe prodhuesve të ndryshëm, mallrat e të cilëve janë paraqitur nga operatori ekonomik, ashtu siç kërkohet në DST.
- Nuk plotëson pikën 5 të Kapacitetit Teknik. Në lidhje me artikujt e kërkuar me nr rendor 12 dhe 13 “Instrument matës temperature me një sensor NTC me Bateri”, nga katalogët e paraqitur nga operatori ekonomik rezulton se ato janë instrumenta matës temperature që përdoren në matjen e temperaturës së ajrit dhe fenomeneve të tjera në fushën e meteorologjisë dhe jo të metrologjisë, që janë dy fusha krejt të ndryshme. Instrumentat matës kërkuar nga ana e Autoritetit Kontraktor në këtë rast janë instrumenta matës termometra që përdoren në matjen e temperaturës së lëngjeve, konkretisht karburenteve sipas specifikimeve përkatëse. Në lidhje me artikullin me numër rendor 16. “Aparat për matjen e volumit të gazit”, nuk është paraqitur asnjë katalog apo e dhënë. Gjithashtu të gjitha katalogjet e paraqitura nuk janë të përkthyer në gjuhën shqipe, ashtu siç është përcaktuar në DST, faqe 7, pika 4.6.
- Nuk plotëson pikën 7 të Kapacitetit Teknik, pasi nuk është paraqitur asnjë deklaratë nga distributori i autorizuar ose prodhuesi, për periudhën e garancisë, ashtu siç kërkohet në DST.
- Nuk plotëson pikën 8 të Kapacitetit Teknik, pasi në ditën dhe orën e hapjes së ofertave nuk ka paraqitur mostrat e kërkuara.

- Nuk plotëson pikën 9 të Kapacitetit Teknik, pasi tabela e kërkuar nuk është paraqitur sipas formatit të kërkuar. Tabela e paraqitur nuk përmban kodet e produkteve dhe nr e faqes së katalogjeve për secilin produkt.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1) “NOVAMAT” SHPK
Emri i plotë i shoqërisë

K81615002O
numri i NIPT-it

Vlera e ofruar: 4.919.000 (katër milion e nëntëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë Autoritetit Kontraktor, Inspektoriati Shtetëror i Mbikqytjes së Tregut, me adresë: Sheshi Skënderbej, nr.3, Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 29.07.2020.

Ankesa: JO.

BASHKIA SHKODËR

Nga: Bashkia Shkodër

Adresa: L.”Vasil Shanto”,Rr.”13 Dhjetori”, Tel & Fax +35522400150.

Për: ”InfoSoft Office” sh.p.k. Adresa: Kashar Kodër Kashar, Autostrada Tirane-Durres, Km 8, Tiranë me NUIS J62426002Q

Procedura e prokurimit: Kerkese per Propozim

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje materiale kancelarie per nevojat e Bashkise dhe institucioneve të varesise” (Blerje e përqëndruar).

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-63022-06-26-2020

Fondi limit (nqs ka lotë i ndarë sipas lotëve): 3,778,091 (tremilion e shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e nëntëdhjetë e një) lekë pa tvsh.

Burimi i Financimit: Buxheti i Bashkise viti 2020.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Afati i përfundimit të shërbimit: 30 (Tridhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike datë 06.07.2020 nr. 41.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 17.07.2020, ora 10.00

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë keta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik "BLINISHTA" sh.p.k me administrator z. Lazer Blinishta me NIPT K16513001T.
Nuk ka paraqitur ofertë.
2. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik "InfoSoft Office" sh.p.k me NUIS J62426002Q me administrator z. Gëzim Dobi perfaqesuar me prokure te posacme nga z.Frederik Prodani.
Me ofertë në total prej 2,696,711 lekë pa tvsh.
3. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik "INTERLOGISTIC" sh.p.k me NUIS K21605003M me administrator z. Edmond Hido.
Me ofertë në total prej 2,896, 182.40 lekë pa tvsh.
4. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik «IT Gjergji Kopjuter» shpk me NUIS K81503063B me administrator z. Pier Joti.
Me ofertë në total prej 3,179,111 lekë pa tvsh.
5. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik «MARKETING & DISTRIBUTION» sh.p.k me NUIS J72124001N me administrator z. Sokol Vehbi.
Me ofertë në total prej 3,698,038.76 lekë pa tvsh.
6. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik «TIM» sh.p.k me NUIS K46523066Q me administrator z. Mehdi Bekteshi.
Me ofertë në total prej 2,950,370 lekë pa tvsh.

Ka ofertues të skualifikuar.

- 1- U skualifikua operatori ekonomik "BLINISHTA" sh.p.k per keto arsye:
 - Ju nuk keni paraqitur asnje dokument
- 2- U skualifikua operatori ekonomik "TIM" sh.p.k per keto arsye:
 - Ju nuk keni paraqitur asnje dokument

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, "InfoSoft Office" sh.p.k. me administrator z. Gëzim Dobi perfaqesuar me prokure te posacme nga z.Frederik Prodani. Adresa: Kashar Kodër Kashar, Autostrada Tirane-Durres, Km 8, Tiranë me NUIS J62426002Q se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej 2,696,711 (dy milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtëmijë e shtatëqind e njëmbëdhjetë) lekë pa tvsh, është identifikuar si oferta më e sukseshme e paraqitur.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Njesisë së Prokurimeve Publike, Bashkia Shkodër, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) diteve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi. Gjithashtu duhet të paraqitni të gjithë dokumentacionin e hedhur në tender origjinal ose kopje të noterizuar, të numerizuar dhe të inventarizuar. Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar), siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 27.07.2020.

Ankesa.Nuk ka patur

DREJTORIA E SHERBIMIT SPITALOR KUKES

Për: KRIJON Shpk me Nipt-K12023001A
Rruga Todi Shkurti, Pallati 5/1, Shk.1, Ap.2 Tiranë.

* * *

Procedura e prokurimit: Kërkese per propozim Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë(*me nje OE fitues per secilin lot*) – ku të gjitha kushtet jane të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj)

Nr referenece Procedure REF-63189-06-29-2020

Nr reference LOTI 2 Reagentë _REF-63198-06-29-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje Kite , Reagente dhe Materiale Konsumi per nevojat e Spitalit Kukës e ndare ne 3 lote” Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë (*me nje OE fitues per secilin lot*) – ku të gjitha kushtet jane të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj), meFondin limit/Vlera e pritshme e kontratës per lotin 2 Reagentë është: 24.300 (njëzet e katër mijë e treqind) Lekë pa Tvsh dhe Shumatorja e çmimeve për njësi është: 14.640(katërmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet) Lekë pa tvsh, me afatkohor për ekzekutimin: Duke filluar nga data e lidhjes së kontratës/kontratave me përfundim deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor sipas marrëveshjes kuadër.

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [] []

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara :

1.KRIJON sh.p.k K12023001A

Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera 10.670(*dhjete mijë e gjashte qind e shtatedhjete*) leke pa Tvsh dhe me Vlerë të pritshme të kontratës 19.670(*nentembedhjete mijë e gjashteqinde e shtatedhjete*) leke pa tvsh dhe 23.604(*njezet e tre mijë e gjashteqind e kater*) leke me Tvsh.

(*me numra dhe fjalë*)

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm: S’ka

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se jane identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1.KRIJON Shpk K12023001A

*Emri i plotë i shoqërisë**numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera 10.670(dhjetë mijë e gjashtë qind e shtatëdhjetë) leke pa Tvsh dhe me Vlerë të pritshme të kontratës 19.670(nentëmbëdhjetë mijë e gjashtëqinde e shtatëdhjetë) leke pa tvsh dhe 23.604(njzet e tre mijë e gjashtëqind e kater) leke me Tvsh.

I.1 Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [Drejtorisë Shërbimit Spitalor Kukës], brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 21.07.2020

Ankesa: JO

DREJTORIA E SHERBIMIT SPITALOR KUKES

Për: KRIJON Shpk me Nipt-K12023001A

Rruga Elbasanit nr 57, Farkë Tiranë .

* * *

Procedura e prokurimit: Kërkese për propozim Marrëveshje Kuadër me disaoperatorëekonomikë(me nje OE fitues per secilin lot) – ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj)

Nr referenece Procedure REF-63189-06-29-2020

Nr reference Loti 3.Materiale Konsumabel REF-63200-06-29-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje Kite , Reagente dhe Materiale Konsumi për nevojat e Spitalit Kukës e ndare në 3 lote” Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë (me nje OE fitues per secilin lot) – ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj), me Fondin limit/Vlera e pritshme e kontratës për lotin 3 Materiale Konsumabel është: 1.632.170 (një milionë e gjashtëqind e tridhjetë e dy mijë e njëqind e shtatëdhjetë) Lekë pa Tvsh dhe Shumatorja e çmimeve për njësi është: 54.485,4 (pesëdhjetë e katër mijë e katërqind e tetëdhjetë e pesë presje katër) Lekë pa tvsh, me afat kohor për ekzekutimin: Duke filluar nga data e lidhjes së kontratës/kontratave me përfundim deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor sipas marrëveshjes kuadër.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [] []

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara :

1.KRIJON sh.p.k

K12023001A

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera 20.061,4(njzet mijë e gjashtëdhjetë e nje presje kater) leke pa Tvsh me vlere të pritshme të kontratës 1.619.000(nje milion e gjashtëqind e nentëmbëdhjetë mijë)leke pa Tvsh dhe 1.942.800(nje milion e nentëqind e katerdhjetë e dy mijë e teteqind)leke me Tvsh.

(me numra dhe fjalë)

2.Gama sh.p.k

K31510153H

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera 19.170,40(nentembedhejte mije e njeqind e shtatedhjete presje kater dhjetë) leke pa Tvsh.

(me numra dhe fjalë)

3.Fedos sh.p.k

K01514009I

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera 18.728,8(tetembedhjete mije e shtateqinde e njezet e tete presje tete) leke pa Tvsh.

(me numra dhe fjalë)

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1.Gama sh.p.k

K31510153H

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme: S’kualifikohet pasi OE: Gama shpk nuk plotesoi piken 5 për kapacitetin teknika , pika 5 Ofertuesi duhet te paraqese mostra per artikujt qe prokurohen te cilat dergohen ne zyrat e Sekretarise te Drejtorise Sherbimit Spitalor Kukes te paketuara me shenimet: “Per komisionin e vleresimit te ofertave te procedures”Blerje kite dhe reagente per laboratorin Spitali Kukes” me shenimin *Mos e hapni, me perjashtim te rasteve kur eshte i pranishem komisioni i vleresimit te ofertave dhe jo me pare se data 13.07.2020 ora 14:00*

Nese mostrat e dorezuara, nuk jane te shoqeruar me listen e inventarizimit dhe te identifikuara sipas numrit rendor te formularit te çmimit, nese ka mungesa mostrash per artikuj te veçante ose nese origjina e stampuar mbi moster nuk perputhet me origjinen e deklaruar nga oferuesi atehere oferta do te quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do te s’kualifikohet.

2.Fedos sh.p.k

K01514009I

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme: S’kualifikohet pasi OE: Fedos shpk nuk plotesoi piken 5 për kapacitetin teknika , pika 5 Ofertuesi duhet te paraqese mostra per artikujt qe prokurohen te cilat dergohen ne zyrat e Sekretarise te Drejtorise Sherbimit Spitalor Kukes te paketuara me shenimet: “Per komisionin e vleresimit te ofertave te procedures”Blerje kite dhe reagente per laboratorin Spitali Kukes” me shenimin *Mos e hapni, me perjashtim te rasteve kur eshte i pranishem komisioni i vleresimit te ofertave dhe jo me pare se data 13.07.2020 ora 14:00*

Nese mostrat e dorezuara, nuk jane te shoqeruar me listen e inventarizimit dhe te identifikuara sipas numrit rendor te formularit te çmimit, nese ka mungesa mostrash per artikuj te veçante ose nese origjina e stampuar mbi moster nuk perputhet me origjinen e deklaruar nga oferuesi atehere oferta do te quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do te s’kualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se jane identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1.KRIJON Shpk K12023001A

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera 20.061,4(njezet mije e gjashtedhjete e nje presje kater) leke pa Tvsh me vlere të pritshme të kontratës 1.619.000(nje milion e gjashteqind e

nentembedhjetë mijë)leke pa Tvsh dhe 1.942.800(një milion e nentëqind e katerdhjetë e dy mijë e teteqind)leke me Tvsh.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [Drejtorisë Shërbimit Spitalor Kukës], brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 21.07.2020

Ankesa: JO

AGJENCIA RAJONALE E SHERBIMIT VETERINAR DHE MBROJTJES SE BIMEVE SHKODER

Për: [BOE „BLINISHTA“ sh.p.k. & „DELIA IMPEX“ sh.p.k., Adresa Blinishta: Fshati Omaraj, Gruemire, Malesi e Madhe. Adresa Delia Impex :Qender Bajze, Kastrat, Malesi e Madhe]
Procedura e prokurimit: KERKESE PER PROPOZIM

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-64551-07-07-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: /Kontrata me objekt “Rikonstruksion I ambienteve te ARSHVMB Shkoder, sherben per te rikonstruktuar godinen e Agjencise Rajonale te Sherbimit Veterinar dhe Mbrojtjes se Bimeve Shkoder, ne menyre qe te krijohen kushte me optimale per pune dhe te jepet sherbim me cilesor ndaj qytetareve, parashikohet per tu realizuar per nje afat prej 60 ditesh/
Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. ___date 09.07.2020
Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1.” BOE „BLINISHTA“ sh.p.k. & „DELIA IMPEX“ sh.p.k., K 16513001 T & K 57123001 R
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Vlera 3 430 092 (Tre milion e katerqind e tridhjetë mijë e nentëdhjetë e dy) leke pa tvsh

2. “ELDA - VL”SH.P.K. K 67106202 W
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Vlera 0 (Zero) leke pa tvsh

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. “ELDA - VL”SH.P.K. K 67106202 W
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Shoqeria “Elda - VI” sh.p.k., skualifikohet sepse : Nuk ka paraqitur asnje prej dokumentave te kerkuara ne kriteret e pergjithshme dhe te vecanta te kualifikimit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [BOE „BLINISHTA“ sh.p.k. & „DELIA IMPEX“ sh.p.k., Adresa Blinishta: Fshati Omaraj, Gruemire, Malesi e Madhe. Adresa Delia Impex : Qender Bajze, Kastrat, Malesi e Madhe] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [3 430 092 (Tre milion e katerqind e tridhjetë mijë e nentedhjetë e dy) leke pa tvsh]/pikët totale të marra [NUK KA] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Agjencia e Sherbimit Veterinar dhe Mbrojtjes se Bimeve Shkoder, me adrese Zulevardi Zogu i I-re, Shkoder, prane Z.Besmir Kolçe] sigurimine kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [NUK KA], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006“Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 29.07.2020

Ankesa: ka ose jo NUK KA
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë NUK KA

UNIVERSITETI ALEKSANDER MOISIU DURRES

Për: BO-MENI sh.p.k dhe “XHENGO” sh.p.k

Adresa: TIRANE Njësia Bashkiake Nr. 8, Rruga Shinasi Dishnica, Pallati UniCom Nr. 1, Hyrja A, Kati 2-të

Procedura e prokurimit: Kërkesë Për Propozim

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-63325-06-30-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Sherbime dhe mirembajtje e objekteve ndertimore”

Publikime të mëparshme *Nuk zbatohet*: Buletini i Njoftimeve Publike

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët Xoferta ekonomike më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë 9 (nente) ofertues me vlerën përkatëse të ofruar si me poshtë :

1. Operatori ekonomik 2 N sh.p.k NUIS L31615017L me ofertë ekonomike 2,092,672 lekë

- pa TVSH dhe 2,511,206 lekë me TVSH.
2. Operatori ekonomik CARA sh.p.k NUIS K07729920F me ofertë ekonomike 2,750,540 lekë pa TVSH dhe 23,300,648 lekë me TVSH.
 3. Operatori ekonomik ELDA- VL sh.p.k NUIS K67106202W ofertë ekonomike nuk ka paraqitur.
 4. Operatori ekonomik ERIL B&B sh.p.k NUIS L81426509M me ofertë ekonomike 2,180,200 lekë pa TVSH dhe 2,616,240 lekë me TVSH.
 5. Operatori ekonomik KUPA sh.p.k NUIS K51615512C me ofertë ekonomike 3,256,600 lekë pa TVSH dhe 3,907,920 lekë me TVSH.
 6. Operatori ekonomik MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE sh.p.k NUIS K81314023A me ofertë ekonomike 2,781,802 lekë pa TVSH dhe 3,338,162.4 lekë me TVSH.
 7. Operatori ekonomik MENI sh.p.k NUIS J61909018W dhe "XHENGO" sh.p.k me NUIS J64103171M me ofertë ekonomike 2,040,960 lekë pa TVSH dhe 2,449,152 lekë me TVSH.
 8. Operatori ekonomik RAFIN COMPANY sh.p.k NUIS L52125110A me ofertë ekonomike 2,716,800 lekë pa TVSH dhe 3,260,160 lekë me TVSH.
 9. Operatori ekonomik SPEKTRI sh.p.k NUIS J62903555F me ofertë ekonomike 2,870,220 lekë pa TVSH dhe 3,444,264 lekë me TVSH.

Ngashqyrtim dhe vlerësim i dokumentacionit të paraqitur nga OE rezultoi si mëposhtë:

1. Operatori ekonomik 2 N sh.p.k NUIS L31615017L me ofertë ekonomike 2,092,672 lekë pa TVSH dhe 2,511,206 lekë me TVSH nuk është në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike të kërkuara në DST dhe për këtë arsye nuk kualifikohet pasi :
 - Nuk përmbush pikën 2.3.1 për Kapacitetin Teknik, në të cilën kërkohet: *"Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojë të mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël sa 40% të vlerës së përllogaritur të Kontratës që prokurohet.*
Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:
 - Për kontratat e realizuara me ent publik si dëshmi pranohen vertetimet të lëshuara nga një ent publik dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat shumat dhe shërbimet e realizuara.
 - Për kontratat e realizuara me subjekte private si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes (ku të shprehen qartë datat, shumat dhe shërbimet e realizuara".

Operatori Ekonomik nuk ka arritur të dëshmoj përbushjen e kësaj pike pasi nuk ka sjellë dokumentacion provues si dëshmi për përvojë të mëparshme për punë të ngjashme me punën objekt prokurimi.

- Nuk përbush pikën 2.3.7 për Kapacitetit Teknik të kriterëve të veçanta të kualifikimit, në të cilën kërkohet:

“Operatori ekonomik për materialin e Mapei dhe materialin e bojrave duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar me te cilet bashkepunon.

- Ne rast paraqitje autorizim prodhuesi operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentin origjinal si dhe te perkthyer ne gjuhen shqipe nga perkthyes te licensuar nga Ministria e Drejtesise. Autorizimi duhet te permbaje te dhenat e sakta te prodhuesit adresen postare, telefon, fax, e-mail, ëebsite zyrtar ne menyre qe autoriteti kontraktor te kete mundesi te kryej te gjitha verifikimet e nevojshme per autenticitetin e tij.

- Ne rast paraqitje Autorizimi Distributori OE duhet te paraqesi dokumentin origjinal si dhe te perkthyer ne gjuhen shqipe nga perkthyes te licensuar nga Ministria e Drejtesise. Autorizimi duhet te permbaje te dhenat e sakta te distributorit adresen postare, telefon, fax, e-mail, ëebsite.

Gjithashtu OE per te vertetuar lidhjen ndermjet prodhuesit dhe distributorit duhet te paraqese kontrate ose akt marreveshje te vlefshme midis prodhuesit dhe distributorit.”

Operatori Ekonomik nuk ka arritur të dëshmoj përbushjen plotësisht të kësaj pike pasi ka paraqitur autorizimin e distributorit për materialin Mapei por nuk ka paraqitur autorizimin e prodhuesit për distributorin për furnizimin me këtë material. Operatori Ekonomik nuk ka arritur të dëshmoj lidhjen e distributorit me prodhuesin e materialit Mapei nga i cilin pretendon se do furnizohet për përbushjen e kontratës që prokurohet.

2. Operatori Ekonomik “CARA sh.p.k NUIS K07729920F me ofertë ekonomike 2,750,540 lekë pa TVSH dhe 23,300,648 lekë me TVSH nuk është në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike të kërkuara në DST dhe për këtë arsye nuk kualifikohet pasi:

